



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:061023

Datë: 05.11.2020

Numri i dokumentit: 01246412

P.nr.1001/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Sabit Sadikaj në çështjen penale kundër të pandehurit N.F. për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314, par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.922/20 të datës 28.05.2020, jashtë seancës, me datë 03.11.2020, mori:

A K T G J Y K I M

Pranohet Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.922/20 të datës 28.05.2020 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

N.F., nga i ati H. dhe e ëma F., i lindur me (data e lindjes...) në fshatin K., ku edhe tani banon, me numër personal ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Nga data e pa vërtetuar deri me datë 14.02.2019, në shtëpinë e tij në Prishtinë, me qëllim që vetit ti sjell përfitim të paligjshëm, ka vjedhur energjinë elektrike duke e marr dhe shfrytëzuar pa autorizim të K...-it si furnizues i autorizuar, në atë mënyrë që ditën e incidentit gjatë kontrollit te kryer nga personat e autorizuar nga K... u konstatua se përreth qelqit të njehsorit elektrik me numër 8240193, nga ana e djathtë ishte futur shirit filmik duke e penguar punën e diskut, me c'rast i ka shkaktuar dëm të dëmtuarës K... në shumën prej 443.69 EUR,

- me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve e paraparë dhe e sanksionuar me nenin 314 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform neneve 4; 7; 17; 21; 41; 43; 46 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 150.00€ (njëqind e pesëdhjetë) EUR, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar, i pandehuri mund ta paguaj deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, por jo më shumë se 2 (dy) muaj nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur çdo 20 (njëzet) Euro me një ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet procedurës penale aq sa do të llogaritet sipas shpenzimeve përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara: K...- Sh.A, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.922/20 të datës 28.05.2020, ka akuzuar N.F., për shkak të veprës penale, Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetimin se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal dhe provat e propozuara lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës së propozuar e që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga i pandehuri.

Gjyqtari i çështjes, konform nenit 493 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të cilave vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, Kallëzimi penal, raporti fillestar i incidentit, raporti i oficerit, deklaratat e të pandehurit, si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u mor konform nenit 450 par. dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt civil është marrë në bazë të nenit 463 par. 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- Departamenti i Përgjithshëm-
P.nr.1001/20 të dt.03.11.2020

Gjyqtari,
Sabit Sadikaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi - urdhri ndëshkimor, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimet të njëjtit, në këtë gjykatë.

Numri i lëndës: 2020:061023
Datë: 05.11.2020
Numri i dokumentit: 01246412